

**GJON BORIÇI**

**MARRËDHËNIA E NGUSHTË SHQIPËRI-KINË GJATË  
LUFTËS SË FTOHTË DHE "TEORIA E TRI BOTËVE"**

**Procesi i destalinizimit dhe afrimi shqiptaro-kinez**

Në fillimin e viteve '60 të shek. XX, acarimi i marrëdhënieve politike ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Kinës kishte ardhur si "varkë shpëtimi" për pushtetin personal të Enver Hoxhës.<sup>1</sup> Te Shqipëria e vogël, Republika Popullore e Kinës duket se kishte gjetur zëdhënësen e saj politike, por edhe kulturore në kontinentin evropian. Ajo që kishte afruar më së shumti Shqipërinë dhe Kinën ishte padyshim faktori ideologjik dhe në një farë mase edhe ai gjeografik për shkak të pozitës së Shqipërisë në Ballkan. Politika e destalinizimit e iniciuar nga Nikita Hrushovi me fjalimin e famshëm sekret në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në shkurt të 1956-ës mbi krimet e Stalinit, kishte tronditur udhëheqjet komuniste të Tiranës dhe të Pekinit.<sup>2</sup> Krahas përplasjeve ideologjike ndikuan jo pak edhe faktorët gjeografikë, historikë, personalë, kontekstualë dhe ekonomikë.<sup>3</sup>

Më 25 shkurt 1956, Nikita Sergejeviç Hrushov (Nikita Sergeyevich Khrushchev) i cili kishte marrë frerët e pushtetit në Bashkimin Sovjetik, foli hapur kundër Stalinit. Hrushovi e cilësoi Stalinin si "psikopat brutal, i yshtur nga një mani persekutimi me përmasa të pabesueshme, ku kulti i tij personal dhe egozimi i tij kishte çuar drejt vdekjes miliona burra dhe gra të pafajshëm".<sup>4</sup> Kopje të fjalimit sekret të Hrushovit iu shpërndanë të gjithë delegatëve në Kongres. Delegatët kinezë të pranishëm në kongres, Ten Hsiao Pin (Deng Xiaoping) dhe Çu De (Zhu De), u kthyen me

<sup>1</sup> Ana Lalaj, "Një libër që na mungonte", recensë për librin *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë (1956-1978)*, autori Gjon Boriçi, Tiranë: MIRGEERALB, 2016, f. 7.

<sup>2</sup> Sergey Radchenko, *Two suns in the heavens - The Sino-Soviet struggle for supremacy, 1962-1967*, Washington DC.: Stanford University Press, 2009, f. 24.

<sup>3</sup> *Po aty*.

<sup>4</sup> Philip Short, *Mao - The man who made China*, London: I.B. Tauris, 2017, f. 442.

urgjencë në Kinë me një kopje të fjalimit, i cili u përkthye me nxitim të madh.<sup>5</sup>

Për Mao Ce Dunin, fjalimi i Hrushovit kishte hapur "kutinë e Pandorës". Për Maon kjo do të thoshte që njerëzit në regjimet komuniste do të fillonin të mos kishin frikë dhe t'i flisnin gjërat ashtu si mendonin. Por, nuk ishte vetëm ky problemi. Për Maon, qëndrimi i Hrushovit nuk ishte një qasje e drejtë. Madje, ai e kishte cilësuar kursin e ri sovjetik të destalinizimit si antimarksist dhe revizionist.<sup>6</sup> Gjashtë javë pas fjalimit sekret të Hrushovit, Mao Ce Duni doli me një deklaratë publike të botuar në gazetën "Zhenminzhibao" (E Përditshmja Popullore) për të sqaruar pozicionin e Partisë Komuniste Kineze:

*"Çfarëdo gabimesh që mund të jenë bërë, diktatura e proletariatit është për masat popullore shumë herë më superiore sesa diktatura e borgjezisë...Disa njerëz mendojnë se Stalini e kishte gabim në gjithçka: ky është një mendim tepër i rëndë dhe i gabuar...Ne duhet t'a shikojmë Stalinin nga një pikëvështrim historik, të bëjmë një analizë të hollësishme për të parë ku e kishte mirë dhe ku e kishte gabim dhe të nxjerrim mësimet e duhura nga kjo. Edhe gjërat që ka bërë mirë edhe gjërat që ka bërë gabim, ishin fenomene të lëvizjes ndërkombëtare komuniste dhe mbajnë vullën e kohërave".<sup>7</sup>*

Kjo nuk do të thoshte se udhëheqësi kinez e adhuronte në mënyrë të verbër Stalinin. Në takimin që lideri kinez zhvilloi me Enver Hoxhën në tetor të vitit 1956, i shprehet ndryshe për ish udhëheqësin sovjetik, kur Hoxha ia ngriti në qiell, duke i thënë:

*"Stalini ka bërë gabime. Ai ka bërë gabime edhe ndaj nesh...edhe ndaj shokëve jugosllavë ai ka gabuar. Pa gabuar nuk mund të ecet. Është e nevojshme të gabohet".<sup>8</sup>*

Prekja e kultit të individit nga Nikita Hrushovi ishte si një kovë me ujë të përvëlur në kokën e udhëheqësit komunist shqiptar Enver Hoxha. Sipas Hoxhës, revizionizmi i ri sovjetik nuk do të ishte i ndryshëm nga ai jugosllav. Për të ruajtur pushtetin e tij, çdo mendim që do të ishte ndryshe do të goditej. Fakt për këtë është Konferenca e Tiranës e prillit 1956, ku Hoxha rivendosi me grusht të rëndë autoritetin e tij. Kritikën për

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Lorenz M. Lüthi, *The Sino-Soviet split - Cold War in the Communism World*, New Jersey: Princeton University Press, f. 1.

<sup>7</sup> Ph. Short, *Mao - The man who...*, f. 443.

<sup>8</sup> Enver Hoxha, *Hrushovianët*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 232.

udhëheqjen e Partisë, Enver Hoxha në atë konferencë i konsideroi si kundërvënie ndaj saj.<sup>9</sup> Me këtë akt, ai bëri të ditur se nuk e pranonte kursin e destalinizimit ashtu si dhe Mao Ce Duni. Në këtë kohë, në Shqipëri, ai [Hoxha] filloi të instalojë në popull politikën e kursimit dhe sloganin absurd "mbështetje në forcat tona" dhe sulmoi ashpër në mbledhjen e 81 partive komuniste të mbledhura në Moskë në nëntor 1960 kursin e destalinizimit.<sup>10</sup> Por, edhe Nikita Hrushovi iu përgjigj me ashpërsi dhe qartë Enver Hoxhës duke deklaruar hapur:

*"T'i japësh fund kultit të individit do të thotë për Shehun, Hoxhën e të tjerë të heqësh dorë në esencë prej posteve komanduese në parti e në shtet. Por, këtë gjë ata nuk duan ta bëjnë. Ne jemi të bindur se do të vijë koha kur komunistët shqiptarë, kur populli shqiptar do të thonë fjalën e tyre dhe atëherë udhëheqësit shqiptarë do të duhet të japin përgjigje për atë dëm që ata i shkaktuan vendit të tyre, popullit të tyre".<sup>11</sup>*

Më 3 dhjetor 1961, Bashkimi Sovjetik kreu aktin e fundit të njëanshëm, ndërprerjen përfundimtare të marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë.<sup>12</sup> Ajo që shpëtoi pushtetin e Enver Hoxhës dhe atë vetë, ishte acarimi i marrëdhënieve politike ndërmjet Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Në gjysmën e dytë të viteve '50 dhe saktësisht në vitin 1956, Hrushovi kishte dalë me tezën e "bashkekzistencës paqësore" me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga viti 1957 e tutje, kjo tezë shërbeu për vijimin e konfliktit ideologjik ndërmjet dy vendeve të mëdha komuniste.<sup>13</sup> Tashmë, ishte shumë e qartë se Kina do ta kopjonte eksperiencën sovjetike në mënyrë selektive. Ky fakt vërtetohet nga fjalët e Mao Ce Dunit në vitin 1957, të deklaruara gjatë fushatës së 100 Luleve, e që ishin tepër sfiduese për lidhshypin sovjetik në botën komuniste:

*"Ne kemi ende nevojë të mësojmë nga Bashkimi Sovjetik. Megjithatë ne do të mësojmë prej tyre në mënyrë selektive, vetëm do të pranojmë gjërat e mira dhe do të shmangim gjërat e këqia".<sup>14</sup>*

<sup>9</sup> Ana Lalaj, *Pranvera e rrejshme e 56-s*, Tiranë: Infbotues, 2015, f. 58.

<sup>10</sup> L. M. Lüthi, *The Sino-Soviet split...*, f. 189.

<sup>11</sup> *Po aty*, f. 102

<sup>12</sup> *Po aty*, f. 105.

<sup>13</sup> *Po aty*, f. 2.

<sup>14</sup> *Brothers in arms - The rise and fall of the Sino-Soviet alliance 1945-1963*, ed. Odd Arne Westad, Woodrow Wilson Center Press/Stanford University Press, Washington: 1998, f. 17.

### **Aleanca e "madhe" mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës në vitet '60**

Aleanca dhe lidhja e fortë mes dy vendeve me regjim politik të njëjtë siç ishin Shqipëria dhe Kina, do të shkaktonte habi në Evropë dhe në botë. Një fakt interesant është se, Shqipëria kishte qenë një nga vendet e para të Bllokut Komunist që kishte njohur dhe vendosur marrëdhënie diplomatike me Republikën Popullore të Kinës, qysh më 19 nëntor 1949<sup>15</sup>, një muaj e gjysëm pas fitores së komunistëve të Mao Ce Dunit ndaj forcave nacionaliste të Çan Kai Shisë. Ndhimat dhe kreditë për Shqipërinë që u ndërprej prej Bashkimit Sovjetik, u zëvendësuan menjëherë nga Republika Popullore e Kinës. Në një takim të datës 17 janar 1961 ndërmjet Spiro Kolekës, zv/kryeministër i Shqipërisë dhe Çu En Lait, kryeministri kinez premtoi se Kina do ta ndihmonte me çdo kusht Shqipërinë dhe se do të garantohej paprekshmëria e kufijve të vendit nëse sulmohej nga Bashkimi Sovjetik.<sup>16</sup> Gjithashtu, në këtë takim, kryeministri kinez Çu En Lai, premtoi kredi të mëdha për Shqipërinë ku është e dukshme dhënia e 100 milion rublave(1.724.137\$) për mekanizimin e bujqësisë, 350 mijë ton grurë me vlerë 10 milion rubla(172.413\$) për vitet 1962-1965 si dhe ndërtimi i 125 veprave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë e industrisë.<sup>17</sup>

Është e nevojshme të theksohet se kjo nuk ishte kredia e parë që Kina i ofronte Shqipërisë. Qysh në takimin e parë dhe të fundit të Enver Hoxhës me kryetarin e Republikës Popullore të Kinës, Mao Ce Dun në tetor 1956, ky i fundit kishte premtuar dhënie e një kredie prej 55 milion rubla(948.275\$) e cila u bë efektive në vitin 1958.<sup>18</sup> Pas vizitës së Enver Hoxhës në vitin 1956 në Pekin, Kina kishte filluar të ndihmonte Shqipërinë. Në një telegram të ambasadorit shqiptar në Pekin, Delo Balili, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në tetor, njoftohej se nga

<sup>15</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti (më tej: *V.*) 1959, dosja (më tej: *D.*) 185, fl. 33. Relacione mbi marrëdhëniet e vendit tonë me Kinën.

<sup>16</sup> *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), fondi (më tej: *F.*) 14/AP-MPKK, V. 1961, D. 1, fl. 1. Takimi i Spiro Kolekës me Çu En Lain, 17 janar 1961.

<sup>17</sup> *Po aty*, fl. 2-3.

<sup>18</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1958, D. 1, fl. 10. Letra e Mao Ce Dunit dërguar Enver Hoxhës lidhur me akordimin e kredisë prej 55 milion rublash, datë 12 dhjetor 1958.

Kina ishin dërguar ndihmat e para për shkollat shqiptare.<sup>19</sup> Zbatimi i planit kulturor ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës zë fill qysh në vitin 1956.<sup>20</sup>

Në gjysmën e parë të viteve '60, kryeministri kinez Çu En Lai do ta vizitonte dy herë radhazi Shqipërinë.<sup>21</sup> Nga ana politike, Shqipëria u kthye në një zëdhënëse të vërtetë të Kinës në arenën ndërkombëtare. Shqipëria, duke qenë shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara e Kina 750 milionëshe çuditërisht jo, vendi i vogël ballkanik përkrahte hapur çdo iniciativë të vendit të madh aziatik në botë.

Më 30 tetor 1963, gjatë Sesionit XVIII të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, Shqipëria kishte iniciuar procesin e pranimit të Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (më tej OKB). Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Behar Shtylla, ia njoftoi këtë fakt, ambasadorit kinez të akredituar në Tiranë në pritjen e mbajtur për nder të tij.<sup>22</sup> Më datë 21 tetor 1963 rezoluta shqiptare kaloi në votim dhe u rrëzua, por pati një rezultat befasues me 42 vota pro, kundra 57 dhe kishin abstenuar 12 vende.<sup>23</sup>

Kjo përpjekje e iniciuar nga një vend i vogël si Shqipëria nuk mbeti pa u vënë re në Kinë. Shqipëria do të ishte përgjatë viteve '60 deri në vitin 1971 kur Kina do të pranohet me të drejta të plota në OKB, zëdhënësjë dhe mbrojtësjë e çdo iniciative kineze në botë, veçanërisht për ndalimin e armëve bërthamore.<sup>24</sup> Enver Hoxha kërkonte me këmbëngulje që Kina të shkëpuste çdo lloj marrëdhënieje me Bashkimin Sovjetik, ashtu siç kishte bërë edhe Shqipëria, por diplomacia nuk funksionon në këtë mënyrë. Enver Hoxha kishte krijuar edhe togfjalëshin e tradhtarëve të marksizmit "Hrushov - Tito - Ulbriht - Gomulkë - Novotni - Zhivkov", ndërkohë që vetes i njihte meritat e liderit ideal të komunizmit.<sup>25</sup>

Gjendja aktuale e të dy vendeve kishte bindur partitë komuniste respektive se Kina kishte nevojë politikisht për Shqipërinë dhe vendi ynë

<sup>19</sup> AMPJ, V. 1956, D. 139, fl. 1. Dhurata e ndihma falas nga R.P. e Kinës.

<sup>20</sup> Po aty, V. 1956, D. 140, fl. 1. Plani kulturor me Kinën dhe zbatimi i tij.

<sup>21</sup> Po aty, V. 1963, D. 238/1 B/I-7, fl. 2.

<sup>22</sup> Po aty, V. 1963, D. 233, fl. 6. Informacion takimesh me ambasadorin kinez Lo Shi Gao për probleme të ndryshme të lidhura me OKB, 15 gusht 1963.

<sup>23</sup> Po aty, fl. 14.

<sup>24</sup> AMPJ, V. 1963, D. 256, fl. 1. Dorëzohet një letër e Çu En Lait për shokun Mehmet Shehu.

<sup>25</sup> Enver Hoxha, *Shënime për Kinën*, vëll. I, Tiranë: 8 Nëntori, 1979, f. 56.

kishte nevojë ekonomikisht për Kinën. Ky fakt, vërtetohet nga vizita 10 ditore e kryeministrit kinez në Tiranë nga data 31 dhjetor 1963 deri më 9 janar 1964.<sup>26</sup> Shqipëria përfitoi ndihma të mëdha ekonomike si dhe do të përmirësohej industria në përpunimin e naftës, kromit, bakrit, hekur-nikelit etj.<sup>27</sup> Vizita e dytë në kohë rekord e kryeministrit kinez Çu En Lai u zhvillua në Tiranë në datat 27-29 mars 1965.<sup>28</sup> Për Shqipërinë, synimi i kësaj vizite, që u pasqyrua me bujë të madhe, ishte realizimi i planit të katërt pesë-vjeçar 1966-1970, ku detyrë kryesore ishte kthimi i vendit nga agraro-industrial në industrialo-agrar.<sup>29</sup> Në pesëvjeçarin e katërt 1966-1970, volumi i ndërtimeve të objekteve industriale që do të ndërtoheshin me ndihmën që kërkohej të jepej nga Republika Popullore e Kinës, do të zinte rreth 28% të volumit të përgjithshëm të ndërtimeve të pesëvjeçarit.<sup>30</sup> Kredia që do të merrte Shqipëria për realizimin e planit katërvjeçar do të lëvrohej në periudhën 1966-1970 dhe do të shlyhej nga Republika Popullore e Shqipërisë pas vitit 1990.<sup>31</sup>

Kjo sipas drejtuesve të lartë të shtetit shqiptar, ishte vizita më e suksesshme që kryeministri kinez kishte kryer në Shqipëri. Me ndihmat dhe kreditë kineze, pushteti i Enver Hoxhës ishte konsoliduar. Tashmë, asgjë nuk do ta pengonte sundimin e tij të gjatë në krye të Republikës Popullore të Shqipërisë. Por, lëvrimi i kredisë iu vonua Shqipërisë për tre vjet duke rënduar së tepërmi ekonominë e vendit. Përse ndodhi kjo? Në vitin 1966, në Kinë shpërtheu Revolucioni i Madh Proletar Kulturor, i cili do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në jetën, ekonominë dhe politikën shqiptare.

### **Shqipëria e "etur" për të marrë mësimet e Revolucionit Kulturor kinez**

Revolucioni Kulturor që u zhvillua në Kinë në vitet 1966-1969, ishte një kataklizëm në kuptimin e plotë të fjalës. Revolucioni Kulturor i

<sup>26</sup> AMPJ, V. 1963, D. 238/1, fl. 12. Mbi vizitën e Çu En Lait në vendin tonë.

<sup>27</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën ...*, f. 65.

<sup>28</sup> AQSH, F. 14/AP-MPKK, V. 1965, D. 4, fl. 1. Procesverbal i bisedimeve mes Enver Hoxhës dhe Çu En Lait më 27-29 mars 1965.

<sup>29</sup> *Po aty*, F.14/AP-MPKK, V. 1965, D. 25, fl. 6. Kopje e letrës e datës 22 janar 1965 lidhur me ndihmën ekonomike të pesëvjeçarit të katërt 1966-1970 që i ka ardhur Komitetit Qendror.

<sup>30</sup> *Po aty*, fl. 22-23.

<sup>31</sup> *Po aty*, fl. 26.

iniciuar nga Mao Ce Duni synonte përmbysjen e madhe të një pjese të klikës së partisë për të konsoliduar më shumë pushtetin e kryetarit. Më 14 maj 1966, u shpaloj daxibaoja (fletërrufeja) e parë kundër rektorit të Universitetit të Pekinit.<sup>32</sup> Kësaj radhe, për të goditur intelektualët u përdor një metodë shumë më e ulët. Fillimisht, si në rastin e rektorit, do t'i njoftohej mbështetja pa kufi për punën e më pas papritmas do të sulmohej barbarisht verbalisht dhe fizikisht. Rektori i Universitetit të Pekinit, Lu Ping, një ditë përpara së t'i shfaqej daxibaoja, kishte marrë garanci nga bashkëshortja e Kan Shenit (Kang Shen) president i Kinës, Cao Yiou, se partia ishte e kënaqur me punën e tij në universitet.<sup>33</sup> Pas dhjetë ditësh, rektori sulmohet nga organizata bazë e partisë së universitetit për shkak të daxibaos. Ai u akuzua se kishte shkelur direktivat e kryetarit Mao mbi Revolucionin Kulturor dhe se kishte qenë kundërshtar i Fushatës së 100 Luleve nëntë vjet më parë.<sup>34</sup>

Revolucioni Kulturor i viteve 1966-1969, edhe pse me zig-zage, zgjati deri në mesin e viteve '70, çoi drejt vdekjes 400.000 mijë vetë si rezultat i keqtrajtimit dhe pengoi një brez të tërë nga shkollimi.<sup>35</sup> Në aplikimin e ideve të tij për Revolucionin Kulturor, Mao aplikoi me mjeshtëri ndërthurjen e modeleve konfuciane dhe komuniste që në thelb ishte një "marrëveshje" ndërmjet popullit dhe shtetit.<sup>36</sup> Sipas teorisë së Maos, nëse shteti [partia] dështonte në detyrimet e saj, atëherë populli [fshatarësia] merrte në dorë situatën.<sup>37</sup> Kjo ishte padyshim e njëjta ide edhe e Menciusit (372-289 p.K), dishepullit të preferuar të Konfucit.<sup>38</sup> Epoka komuniste karakterizohej nga lufta e klasave dhe si e tillë, proletariati kishte të drejtë të luftonte dhe të mposhte borgjezinë dhe idetë e saj. Gjatë epokës së Maos, kjo ide ishte preteksti për shumë ulje-ngritje të mobilizimeve masive të cilat arritën kulmin në vitet e Revolucionit Kulturor.<sup>39</sup>

<sup>32</sup> Ph. Short, *Mao - The man who...*, f. 532.

<sup>33</sup> *Po aty*.

<sup>34</sup> *Po aty*.

<sup>35</sup> Martin Jacques, *When China Rules the World*, second edition, London: Penguin Books, 2012, f. 111.

<sup>36</sup> *Po aty*, f. 112.

<sup>37</sup> *Po aty*.

<sup>38</sup> *Po aty*.

<sup>39</sup> *Po aty*.

Më 8 gusht 1966, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Kineze, urtë e butë, me votë unanime, nënshkroi një dokument në të cilin Mao kishte vënë vulën e tij, që u quajt "16 pikat".<sup>40</sup> Ky dokument ishte hapja rrugë për 'daluan', kaosin e madh, i cili do të përfshinte Kinën në tre vitet e ardhshme.<sup>41</sup> Revolucioni i Madh Proletar Kulturor, ishte një tragjedi që preku çdo gjë njerëzore nga çnjerëzorja, por që Mao e quante "një trend të parezistueshëm"<sup>42</sup>, nga i cili ideologjia feudale dhe borgjeze do të shkatërroheshin. Sipas Maos, ishte një revolucion nga poshtë lart, në të cilin masat do të çlironin vetveten dhe do të kundërshtonin idetë, kulturën dhe zakonet e vjetra.<sup>43</sup> Komunistëve, Mao u thoshte që të kishin besim tek masat, të mbështeteshin tek ato dhe të mos kishin frikë prej tyre.<sup>44</sup> Të njëjtën gjë kishte bërë edhe në vitin 1957 gjatë fillimit të fushatës së 100 Luleve.<sup>45</sup>

Problemi i Maos ishte vazhdimësia e pushtetit. Por, askush nuk e kishte parashikuar se pas vdekjes së tij në vitin 1976, Kina do të hynte në një epokë transformimi rrënjësor shoqëror me suksese ekonomike të paimagjinueshme. Por, kjo ide në vitet '60, në kaosin masiv të Revolucionit Kulturor, ishte e pamundur. Në Kinë, në atë kohë, të gjithë iu nënshtruan thirrjes së Maos:

"...të mësojmë nga revolucioni duke bërë revolucion".<sup>46</sup>

Shumë të rinj iu bashkuan fraksioneve të Gardistëve të Kuq, që ishin një masë paraushtarake e Revolucionit. Zemërimi i tyre ndaj çdo ideje dhe elementi borgjez apo që mendohej si i tillë, ishte në përmasat e një dhune të shfrenuar, duke prekur kufijtë e barbarisë. Ata gjenin frymëzim tek sloganin i Maos që thoshte:

"Të rebelohesh është e justifikueshme".<sup>47</sup>

Ishte një periudhë e tmerrshme për Kinën. Njerëz të paditur që guxonin të përçmonin, poshtëronin mësuesit, pedagogët, inxhinierët, mjekët më të shquar të vendit. Nxënësit e shkollave filluan të djegin

<sup>40</sup> Ph. Short, *Mao - The man who...*, f. 538.

<sup>41</sup> *Po aty*.

<sup>42</sup> *Po aty*.

<sup>43</sup> *Po aty*.

<sup>44</sup> *Po aty*.

<sup>45</sup> *Po aty*.

<sup>46</sup> John King Fairbank & Merle Goldman, *China: A new history*, Cambridge University Press, 2006, f. 392.

<sup>47</sup> *Po aty*.

librat me të njëjtën egërsi si nazistët në majin e vitit 1933. Vetëm në Pekin u shkatërruan 4922 nga 6843 monumente të trashëgimisë kulturore.<sup>48</sup> Qyteti i Ndaluar (që është një nga simbolet e Kinës në botë), u shpëtua vetëm nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë e Çu En Lait.<sup>49</sup>

Edhe pse ishte një kataklizëm i vërtetë, Shqipëria komuniste nën drejtimin e Enver Hoxhës, nxitoi të mësonte nga eksperiencia revolucionare kineze. Në ditarin e tij "Shënime për Kinën" lidhur me Revolucionin Kulturor, Hoxha do të shprehej se "një enigmë e madhe po ngjet në Kinë"<sup>50</sup>, dhe madje shkon më tej kur e quan "një devijim të rrezikshëm ideologjik"<sup>51</sup>, përsëri nuk nguroi të dërgojë në Kinë kryeministrin e vendit, Mehmet Shehun, për një vizitë zyrtare nga data 28 prill deri më 2 maj 1966.<sup>52</sup>

Në fakt ishte folur për një vizitë në muajin prill të vetë Enver Hoxhës në Kinë, por udhëheqësi komunist shqiptar e pa të udhës të mos ndërmernte asnjë aventurë të tillë kur kishte shpërthyer Revolucioni Kulturor dhe kur shkalla e eliminimit fizik ishte e lartë.<sup>53</sup> Më 30 prill 1966, Mehmet Shehu u prit nga Ten Hsiao Pini, i cili ende nuk kishte rënë nga pushtetit si pasojë e politikave të tij liberale duke i thënë kryeministrit shqiptar:

*"Kemi shumë pak intelektualë që janë riedukuar plotësisht e janë proletarizuar. Pas një verifikimi që bëmë, doli se aktorët, shkrimtarët, historianët, filozofët në shumicën e tyre i përmbahen ideologjisë borgjeze. Por këta edukojnë rininë, edukojnë popullin".<sup>54</sup>*

Siç shihet, lufta kundër intelektualëve do të ishte në qendër të vëmendjes. Liu Shaoçi (Liu Shaoqi), i pranishëm në takim do të ndërhynte duke thënë se fushata që po bëhej ishte fushata e komunistëve për edukim socialist. Ai e quajti këtë fushatë si "fushata e katër

<sup>48</sup> *Po aty*, f. 138.

<sup>49</sup> *Po aty*.

<sup>50</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën ...*, f. 228.

<sup>51</sup> *Po aty*, f. 256.

<sup>52</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1966, D. 1, fl. 1. Marrëdhëniet me PK të Kinës.

<sup>53</sup> *Po aty*, fl. 15.

<sup>54</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1966, D. 2, fl. 57-58. Bisedimet e zhvilluara midis delegacionit të Partisë e qeverisë së RPSH në Kinë, të kryesuar nga Mehmet Shehu.

spastrimeve".<sup>55</sup> Ngjarjet në Kinë nuk kishin sesi të mos ndikonin edhe në perceptimin e Mehmet Shehut sesi duhej të evitohet lindja dhe restaurimi i kapitalizmit në Shqipëri.<sup>56</sup> Në takimin me homologun e tij Çu En Lai, Shehu tregohet i sinqertë kur shprehet se:

*"Ne nuk kemi eksperiencë sesi mund të evitohet lindja e revizionizmit dhe restaurimi i kapitalizmit në vendin tonë....Çifligarë ka më pak, sepse të shumtët i kemi pushkatuar ose kanë ikur jashtë, por ka tregtarë, ka fshatarë të mesëm që kanë luftuar me armë në dorë kundër nesh, ka bile edhe disa fshatarë të varfër që kanë luftuar kundër nesh. Fëmijët e tyre janë edhe në universitet dhe janë bërë inxhinierë. Sipas meje nuk mund të injorohet ky faktor i cili përbën një nga elementët që dikton luftën e klasave".<sup>57</sup>*

Edhe deklarata përfundimtare megjithëse nuk u pranua menjëherë nga kryeministri shqiptar, ishte në frymën e këtyre ideve, vendosi bazat për "lindjen e njeriut të ri" në Republikën Popullore të Shqipërisë në frymën e mësimëve të Revolucionit Kulturor Kinez.<sup>58</sup> Ndikimi më i drejtpërdrejtë në Shqipëri i Revolucionit Kulturor kinez ishte padyshim goditja ndaj fesë. Në fillim të vitit 1967 doli dekreti mbi komunitetet fetare ku njihej formalisht liria e besimit, por ishte e pamundur mbrojtja juridike e saj [fesë]. Mbështetur në këtë anarki ligjore, turma të irrituara dhe të yshtura të regjimit filluan të sulmojnë me egërsi institucionet

<sup>55</sup> *Po aty*, fl. 76. Katër fushatat ishin: Spastrimi nga ana politike; Spastrimi nga ana ekonomike; Spastrimi nga ana organizative; Spastrimi nga ana ideologjike.

<sup>56</sup> *Po aty*, fl. 188.

<sup>57</sup> *Po aty*, fl. 188-195.

<sup>58</sup> *Po aty*, fl. 7. Deklarata përfundimtare pati këtë formulim: "Të dy palët janë të mendimit se gjatë gjithë periudhës historike të shoqërive socialiste, në vendet socialiste ekziston lufta e klasave, lufta midis dy rrugëve - rrugës socialiste dhe asaj kapitaliste, ekziston rreziku i lindjes së revizionizmit dhe i restaurimit të kapitalizmit. Për të evituar marrjen në dorë të udhëheqjes së partisë e të shtetit nga elementët revizionistë dhe restaurimin e kapitalizmit, për të konsoliduar e çuar përpara socializmin, si dhe për të siguruar në të ardhmen kalimin në komunizëm, është e domosdoshme t'i përmbahemi vijës revolucionare të marksizëm-leninizmit, t'i përmbahemi diktaturës së proletariatit, të çojmë deri në fund revolucionin socialist në frontin ekonomik, politik, ushtarak, ideologjik e kulturor, është e domosdoshme të edukojmë e të përgatisim vazhduesit e çështjes së revolucionit proletar, besnikë ndaj marksizëm-leninizmit".

fetare. Në këtë pikë, nuk kishte më kuptim mbrojtja e subjekteve fetare.<sup>59</sup> Mësimet nga Kina ishin detyrim për shtetin shqiptar, pasi mbijetesa ekonomike e Shqipërisë ishte tërësisht e varur nga ndihmat e kredive kineze. Në kulmin e dhunës së Revolucionit Kulturor, kryeministri kinez Çu En Lai bëri vizitën e tij të tretë në Shqipëri në datën 24 qershor 1966.<sup>60</sup> Kjo vizitë konfirmoi për Shqipërinë dy kredi të reja ku e para kapte shumën 14 milion e 300 mijë rubla(246.551\$) dhe ishte e përqendruar në sektorin e industrisë së naftës<sup>61</sup>, ndërsa e dyta, kapte shumën e 32 milion e 596 mijë rubla(562.000\$) dhe do të përqendrohej në vijimin e ndërtimit të hidrocentralit të Vaut të Dejës.<sup>62</sup>

Ndihmat dhe kreditë kineze po mbanin në këmbë ekonominë e dobët shqiptare si dhe pushtetin personal të Enver Hoxhës. Mbajtjen në këmbë të këtij pushteti dhe në udhëheqje të vendit, ndikonte edhe fakti se Kina ishte një vend i izoluar ndërkombëtarisht dhe kjo vërtetohej pasi nuk ishte anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Shqipëria në ato vite me një popullsi gati 2 milion banorë kishte zërin e saj në OKB dhe jo pak herë e ka ngritur atë [zërin] në mbrojtje dhe për rivendosjen e të drejtave të Kinës në organizatë. Por, shumë shpejt situata do të ndryshonte. Një vend si Kina me 750 milion banorë në fundin e viteve '60 të shek. XX, nuk mund të rrinte përjetësisht i izoluar nga komuniteti dhe tregtia ndërkombëtare. Ndryshimet konceptuale në politikëbërjen botërore do të sillnin një frymë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Problemi ishte sesi të gjendej rruga për një rigjenerim të marrëdhënieve ndërmjet dy kampeve kundërshtarë. Shqipëria mund të kishte luajtur rolin e saj modest, por me përfitime të mëdha në ekonominë e vendit. Këtë shans ajo e humbi.

<sup>59</sup> Ajet Shahu, "Shteti komunist dhe Kisha Katolike (1945-1967)", në *Krishtërimi ndër shqiptarë (Simpozium ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999)*, Shkodër: Revista Foenix, 2000, f. 364.

<sup>60</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1966, D. 14, fl. 1. Fjala e Enver Hoxhës mbajtur në pritjen e dhënë nga KQ i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH, në Pallatin e Brigadave, për nder të delegacionit të Partisë dhe Qeverisë së RP të Kinës, të kryesuar nga Çu En Lai, datë 24 qershor 1966.

<sup>61</sup> *AMPJ*, V. 1966, D.B/II-1, fl. 51. Çështje të ndryshme të bashkëpunimit ekonomik midis Kinës dhe Shqipërisë.

<sup>62</sup> *Po aty*, fl. 148.

### **Drejt "Teorisë së Tri Botëve": politika trekëndore dhe dilema e Enver Hoxhës**

Katakлизma e Revolucionit Kulturor në Kinë solli vuajtje të mëdha për popullin kinez, por shërbeu edhe si një sinjal për t'i dhënë botës të kuptonte se pushteti i Mao Ce Dunit do të ishte i konsoliduar.<sup>63</sup> Gjeografia e gjerë kineze duhej përfshirë patjetër në arenën ndërkombëtare. Fillimi i viteve '70 të shek. XX, e gjeti Kinën të izoluar ndërkombëtarisht. Ajo nuk ishte shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara. Në mars 1969, kishte ndodhur një konflikt ushtarak, i lokalizuar ndërmjet Kinës dhe Bashkimit Sovjetik për ishullin Çenpao, në verilindje të vendit aziatik.<sup>64</sup> Konflikti mes dy vendeve më të fuqishme të botës komuniste u shfrytëzua mjeshhtërisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilët panë një mundësi të artë tek ky konflikt për të thelluar çarjen e botës komuniste. Në korrik të vitit 1971, presidenti i atëhershëm amerikan Riçard Nikson (Richard Nixon) dërgoi në fshehtësi të madhe asistentin e tij për sigurinë kombëtare, Henri Kisinger (Henry Kissinger) për të biseduar me kryeministrin kinez Çu En Lai lidhur me të ardhmen e marrëdhënieve kino-amerikane.<sup>65</sup> Kisingeri në atë takim e kishte quajtur Kinën një vend të mistershëm, por Çu i ishte përgjigjur:

*"Tani ju duket e mistershme, por kur ta njihni më mirë, nuk do t'u duket aspak e tillë".<sup>66</sup>*

Kryeministri e kishte përgatitur terrenin më parë për afrimin kino-amerikan. Më 6 prill 1971, skuadra amerikane e ping-pongut kishte mbërritur në Pekin me ftesë të kryeministrit kinez. Çu En Lai ia kishte dalë mbanë ta ftonte ekipin amerikan pa acaruar Mao Ce Dunin. Mënyra më e mirë për të fituar aprovimin e Maos ishte që nga Ministria e Jashtme të vinte rekomandimi për të mos e ftuar ekipin amerikan pasi do të ishte

<sup>63</sup> Robert D. Kaplan, *The Revenge of geography. What the map tells us about coming conflicts and the battle against fate*, New York: Random House, 2013, f. 196.

<sup>64</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1969, D. 6, fl. 10-11. Takim i Ramiz Alisë me ambasadorin kinez në Tiranë Gën Biao lidhur me incidentin në lumin Usuri, 26 maj 1969.

<sup>65</sup> Henry Kissinger, *World Order. Reflections on the Character of Nations and the Course of History*, London: Penguin Books, 2014, f. 10.

<sup>66</sup> *Po aty*.

një lëvizje e parakohshme.<sup>67</sup> Kur Mao e lexoi, e quajti një këshillim burokratik të panevojshëm dhe e refuzoi këshillën e ministrisë.<sup>68</sup>

Kur u bë publik takimi Çu En Lai-Henri Kissinger, marrëdhëniet e çiltërta shqiptaro-kineze<sup>69</sup> morën tatëpjetën. Politika trikëndore amerikane e vënë në jetë nga Riçard Nikson dhe Henri Kissinger ku ishin të përfshira Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe Republika Popullore e Kinës, i dha një impuls të ri marrëdhënieve ndërkombëtare. Republika Popullore e Shqipërisë dhe Enver Hoxha do të mbeteshin vetëm pasi komunistë fanatikë nëpër botë nuk do të kishte më me fuqinë ekonomike të Bashkimit Sovjetik dhe të Kinës që të mund të vazhdonin të dërgonin ndihma për vendin e vogël ballkanik. Sikur të mos mjaftonte hapja e Kinës ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Enver Hoxha bëri edhe një gabim shumë të madh duke i shkruar një letër të gjatë 19 faqe kryetarit Mao ku vizitën e ardhshme të presidentit Nikson në Pekin e konsideronte tradhti ndaj marksizëm-leninizmit.<sup>70</sup> Ndaj kësaj letre tërësisht të pakuptimtë dhe të palogjikshme, nuk pati asnjë reagim nga Kina. Megjithatë, për të treguar se miqësia e fortë shqiptaro-kineze vijonte, më 25 tetor 1971, Republika Popullore e Shqipërisë paraqiti në OKB Rezolutën 2758, e cila kërkonte rivendosjen e të drejtave të ligjshme të Kinës në OKB.<sup>71</sup> Pasi u hodh në votim, rezoluta shqiptare fitoi 76 vota pro, 35 kundër dhe 17 abstenime.<sup>72</sup> Lidhur me këtë ngjarje ambasadori shqiptar i atij viti në OKB, Sokrat Plaka, ka shkruar:

*"Rezoluta Bush [Xhorxh Bush ishte në atë kohë ambasador i SHBA në OKB] për zbatimin e 2/3-tave për çështjen e Kinës u hodh poshtë dhe Arabia Saudite votoi kundër. Ambasadori saudit Barudi më tha se njoftoi mbretin se vota kundër Rezolutës amerikane i shërben çështjes palestineze. Në këtë mënyrë Xhorxh Bush humbi dhe kështu u hap rruga për rivendosjen e Kinës në OKB me votim të thjeshtë meqenëse Rezoluta e Bush-it nuk fitoi. Çankaishistët u larguan nga salla e Asamblesë me kokën ulur si uzurpatorë të Kinës".<sup>73</sup>*

<sup>67</sup> Ph. Short, *Mao - The man who...*, f. 608.

<sup>68</sup> *Po aty*.

<sup>69</sup> Henry Kissinger, *On China*, London: Allen Lane, 2011, f. 195.

<sup>70</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1971, D. 3, fl. 48-50. Letra e plotë e Enver Hoxhës dërguar Mao Ce Dunit, 6 gusht 1971.

<sup>71</sup> *Po aty*, f. 236.

<sup>72</sup> Henry Kissinger, *White House Years*, London: Phoenix Press, 2000, f. 784.

<sup>73</sup> Sokrat Plaka, *Kujtime*, Tiranë: Marin Barleti, 2004, f. 33-34.

Rivendosja e të drejtave legjitime të Kinës në OKB ishte një ngjarje me jehonë të lartë botërore. Një treg i ri me 800 milion njerëz i ishte bashkuar komunitetit të kombeve. Vështirë të besohet se Enver Hoxha nuk e kishte kuptuar se tashmë marrëdhëniet shqiptaro-kineze do të binin në rënie të lirë. Sinjali i dytë pas heshtjes ndaj letrës së Hoxhës për ftohjen e marrëdhënies ishte refuzimi i Kinës për të mos dërguar një delegacion në Kongresin VI të PPSH, që do të mbahej në nëntor 1971.<sup>74</sup> Megjithë protestën shqiptare ndaj këtij qëndrimi të deklaruar nga Ramiz Alia në bisedën me ambasadorin kinez në Tiranë,<sup>75</sup> Kina nuk lëvizi nga e vetja. Madje, ambasadori kinez nuk tha asnjë fjalë në takimin me Ramiz Alinë.<sup>76</sup>

Pas takimit dhe deklaratës së përbashkët Mao-Nikson të shkurtit 1972<sup>77</sup>, Enver Hoxha ka shkruar në ditarin e tij për Kinën:

*"Kinezët kanë devijuar ashtu si Hrushovi".<sup>78</sup>*

Devijim apo jo, marrëdhëniet ndërkombëtare në botë po merrnin një rrjedhë tjetër. Marrëveshja Nikson-Mao e vitit 1972 shënoi një ndryshim rrënjësor në çështjet botërore. Nga ky moment, Kina filloi të merrte dimensionin që i takonte në marrëdhëniet ndërkombëtare.

### "Teoria e Tri Botëve"

Në muajin prill të vitit 1974, Mao Ce Duni zgjodhi Ten Hsiao Pinin si drejtues të delegacionit kinez në Kombet e Bashkuara, ku ai shpali mendimet e kryetarit të Kinës mbi çështjet ndërkombëtare të ashtuquajturën "Teori të Tri Botëve".<sup>79</sup> Sipas kësaj teorie, bota ndahej në këtë mënyrë: dy superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe

<sup>74</sup> AQSH, F. 14/AP-MPKK, V. 1971, D. 9, fl. 1. Takim i anëtarit të Byrosë Politike dhe Sekretar i KQ të PPSH Ramiz Alia me ambasadorin e RP të Kinës, datë 14 tetor 1971, mbi komunikimin e përgjigjes së Komitetit Qendror të PK të Kinës që nuk do të dërgojë delegacion në Kongresin VI të PPSH në bazë të vendimit të Kongresit IX të PKK për të mos ftuar në kongreset e veta asnjë parti motër dhe për të mos marrë pjesë në kongreset e partive motra.

<sup>75</sup> *Po aty.*

<sup>76</sup> *Po aty.*

<sup>77</sup> Margaret Macmillan, *Nixon and Mao. The week that changed the world*, New York: Random House, 2007, f. 312.

<sup>78</sup> E. Hoxha, *Shënime për Kinën ...*, f. 651.

<sup>79</sup> Ph. Short, *Mao - The man who...*, f. 617. Për tekstin e plotë të fjalimit të Tenit shih: *Peking Review*, Vol. 17, no. 16, April 19, Beijing: 1974, f. 6-11.

Bashkimi Sovjetik shikoheshin si "Botë e Parë"; kombet e tjera të industrializuara, komuniste dhe kapitaliste shiheshin si "Botë e Dytë"; dhe vendet në zhvillim si "Botë e Tretë".<sup>80</sup> Koncepti i "Teorisë së Tri Botëve" ishte vijim i konceptit tjetër të Maos të quajtur "Katër Modernizimet".<sup>81</sup> 'Katër Modernizimet' ishin qëllimi më i rëndësishëm i lidërshiptit kinez pas reformave ekonomike të filluara. Katër modernizimet përfshinin bujqësinë, industrinë, mbrojtjen kombëtare, shkencën dhe teknologjinë.<sup>82</sup> Ky ishte koncepti gjigant për zhvillimin e ekonomisë kineze i mbrojtur nga kryeministri Çu En Lai sipas instruksioneve të kryetarit Mao në Plenumin e tretë dhe të katërt të Komitetit Qendror të PKK të mbajtur në vitet 1964-1965.<sup>83</sup> Ky koncept u përforcua akoma më shumë një vit përpara vdekjes së Çu En Lait dhe Mao Ce Dunit në vitin 1975.<sup>84</sup> Edhe në vitin 1978, kur Ten Hsiao Pini mori frenat e pushtetit, "Teoria e Tri Botëve" e ndjekur nga 'katër modernizimet' u quajt detyra kryesore që vendi duhej të realizonte.<sup>85</sup>

Për herë të parë gjerësisht, udhëheqja shqiptare u njoh me "Teorinë e Tri Botëve" nga një studim i dërguar prej ambasadorit shqiptar në Kinë, Behar Shtylla më 10 korrik 1976.<sup>86</sup> Në studimin dërguar Komitetit Qendror të PPSH, ambasadori Shtylla, vë në dukje ndryshimet thelbësore në politikën e jashtme të Kinës.<sup>87</sup> Gjithashtu në studim, theksohet se Kina përcakton si rrezikun kryesor Bashkimin Sovjetik dhe jo Shtetet e Bashkuara të Amerikës.<sup>88</sup> Ambasadori shqiptar nuk nguron të theksojë në studimin e tij se, tashmë e rëndësishme për Komitetin Qendror të Kinës ishte "të çojmë përpara punët e Kinës".<sup>89</sup>

Ndryshimin e kursit politik në Kinë, Behar Shtylla e përcakton pas vizitës sekrete të Kisingerit në Pekin në korrik 1971, ku sipas tij slloganet

<sup>80</sup> *Po aty*.

<sup>81</sup> Joseph Yu-shek Cheng, *China's Foreign Policy. Challenges and Prospects*, Singapore: World Scientific Publishing Co., 2016, f. 5.

<sup>82</sup> *Po aty*.

<sup>83</sup> *Po aty*.

<sup>84</sup> *Po aty*.

<sup>85</sup> *Po aty*.

<sup>86</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1976, D. 8, fl. 43. Studimi i ambasadorit të RPSH në RP të Kinës Behar Shtylla, "Teoria e Tri Botëve" dhe qëndrimi ndaj imperializmit.

<sup>87</sup> *Po aty*, fl. 6.

<sup>88</sup> *Po aty*, fl. 8.

<sup>89</sup> *Po aty*, fl. 9.

e famshme marksiste si "Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni" apo "të varrosim imperializmin amerikan, revizionizmin sovjetik dhe shërbëtorët e tyre" nuk dëgjoheshin më.<sup>90</sup> Për udhëheqësit kinezë, Kina ishte akoma vend socialist në zhvillim që i përkiste botës së tretë.<sup>91</sup> Po sipas ambasadorit shqiptar të atyre viteve në Kinë, "Teoria e Tri Botëve" dhe përfshirja e vendeve socialiste në botën e tretë nuk qëndronte në këmbë nga pikëpamja marksiste-leniniste, pasi fshinte ndryshimet midis rrethave shoqërore dhe hidhte poshtë luftën e klasave.<sup>92</sup>

"Teoria e Tri Botëve" fillimisht u kritikua shkarazi në Kongresin VII të PPSH në nëntor 1976, dhe për këtë arsye Komiteti Qendror i PKK-së i dërgoi një letër proteste KQ të PPSH-së më datë 8 dhjetor 1976<sup>93</sup>, ku i thuhej hapur se "në kongresin e 7-të të PPSH u sulmua publikisht me aluzion vija e PKK dhe idetë strategjike të Mao Ce Dunit".<sup>94</sup> Madje, në letër, shkruhej qartë se ky ishte një akt i përsëritur i Shqipërisë dhe se dëmtonte marrëdhëniet kino-shqiptare.<sup>95</sup> Edhe ndaj kësaj kritike të Kinës, Komiteti Qendror i PPSH u tregua i papërmbytur duke i dërguar një letër të gjatë e me ton të lartë më datë 24 dhjetor 1976<sup>96</sup>, ku hidheshin poshtë pretendimet kineze.

Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, "Teorisë së Tri Botëve" të Maos, Enver Hoxha iu përgjigj me një shkrim të pazakontë në vitin 1977, (pas vdekjes së Maos dhe Çu En Lait) në organin zyrtar të KQ të PPSH "Zëri i Popullit" ku sulmohej ajo teori.<sup>97</sup> Në këtë artikull sipas Hoxhës "Teoria e Tri Botëve" ishte antileniniste pasi një vend i vërtetë socialist nuk mund të fuste veten në grupime të tilla si botë e tretë apo e dytë.<sup>98</sup> Po ashtu, "Teoria e Tri Botëve" kishte si qëllim minimin e revolucionit, shuarjen e luftës kundër imperializmit, atij amerikan në mënyrë të veçantë dhe synonte përçarjen e marksizëm-leninizmit dhe unitetin e

<sup>90</sup> *Po aty*, fl. 21.

<sup>91</sup> *Po aty*, fl. 24.

<sup>92</sup> *Po aty*.

<sup>93</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1976, D. 14, fl. 7. Letra e PKK kundër akuzës së PPSH-së në Kongresin VII.

<sup>94</sup> *Po aty*, fl.6.

<sup>95</sup> *Po aty*, fl. 9.

<sup>96</sup> *Po aty*, fl. 39.

<sup>97</sup> "Teoria dhe Praktika e Revolucionit", në *Zëri i Popullit*, nr. 162, Tiranë, 7 korrik 1977, fl. 3-4.

<sup>98</sup> *Po aty*, fl. 4.

proletariatit.<sup>99</sup> Artikulli i "Zërit të Popullit" me citate direkte të Enver Hoxhës i quajtur "Teoria dhe praktika e revolucionit" nuk u pranua nga agjencia kineze e lajmeve Hsinua (Xinhua).<sup>100</sup> Ai iu kthye mbrapsht ambasadës shqiptare në Pekin e cila e kishte dërguar për botim në Kinë. Në një intervistë dhënë agjencisë franceze AFP, lidhur me kritikën e Shqipërisë, Ten Hsiao Pini ishte përgjigjur:

*"Kjo kritikë nuk ka asnjë rëndësi për ne. Përsa na përket neve, ne ndjekim politikën e kryetarit Mao në fushën e politikës së jashtme".<sup>101</sup>*

Në fakt, marrëdhëniet shqiptaro-kineze kishin marrë rrokullimën me kohë. Në vitet 1973-1974, reduktimi i ndihmave dhe kredive kineze kishte filluar spastrimet në aparatin shtetëror shqiptar. Kulmi i reduktimeve kishte ardhur në qershor 1975, kur të dërguarit shqiptar, zv/kryeministrin Adil Çarçani, iu refuzua kërkesa për kredi të re.<sup>102</sup> Ishte shumë e qartë se ndihma nga Kina nuk do të kishte më. Megjithatë, në një përpjekje të fundit, më 12 nëntor 1975, Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu i dërguan një letër të gjatë Komitetit Qendror të PKK, mbi domosdoshmërinë që kishte Shqipëria për t'u pajisur me armë dhe kredi financiare.<sup>103</sup> Edhe kjo përpjekje rezultoi e kotë. Enver Hoxha nuk arrinte ta kuptonte se në rendin e ri botëror që po afirmohej në botë pas pranimit të Kinës në OKB, shteti gjigant aziatik për herë të parë në histori kishte mundësinë të merrte pjesë në rindërtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të pas Luftës II Botërore në kushte shumë të favorshme.<sup>104</sup> Ndryshimet e

<sup>99</sup> Po aty.

<sup>100</sup> *AMPJ*, V. 1977, D. 246, fl. 191. Mbi ndalimin e botimit dhe shpërndarjes së revistës "Shqipëria e Re" nga pala kineze si dhe të buletinit.

<sup>101</sup> *Po aty*, V. 1977, D. 231, fl. 100. Opinione të personaliteteve e diplomatëve të ndryshëm kinezë për vendin tonë dhe udhëheqjen tonë.

<sup>102</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 6, fl. 70. Kopjet e marrëveshjeve dhe të protokolleve të përfunduara midis qeverisë së RPSH dhe qeverisë së RP të Kinës mbi dhënien e një kredie me afat të gjatë dhe shkëmbimin e mallrave për pesëvjeçarim e gjashtë 1976-1980.

<sup>103</sup> *Po aty*, F. 14/AP-MPKK V. 1975, D. 10, fl. 1. Letër e Komitetit Qendror të PPSH, datë 12 nëntor 1975 (firmosur nga Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu) drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, mbi gjendjen dhe nevojat për fuqizimin e mëtejshëm të vendit tonë me armatime e pajisje ushtarake nga ana e Kinës, si dhe dërgimin e një delegacioni ushtarak shqiptar për këtë qëllim në RP të Kinës.

<sup>104</sup> Andrew J. Nathan & Robert R. Ross, *The Great Wall and the Empty Fortress. China's Search for Security*, New York: W.W. Norton Company, 1977, f. 13-14.

mëdha që po ndodhnin në politikën e brendshme e të jashtme të Republikës Popullore të Kinës ishin larg idesë së Enver Hoxhës për tension konstant ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Vetëm duke e mbajtur nën tension popullin shqiptar dhe nën "ombrellën" e një fuqie të madhe komuniste, pushteti i tij do të vijonte.

Në nëntor 1977, në përgjigje ndaj sulmit të Shqipërisë dhe personalisht të Enver Hoxhës ndaj "Teorisë së Tri Botëve", gazeta zyrtare kineze E Përditshmja Popullore botoi një artikull të gjatë editorial me titullin "Teoria e Kryetarit Mao mbi dallimet e tri botëve është një kontribut madhor për Marksizëm-Leninizmin".<sup>105</sup> Në atë shkrim, riafirmohej se dy superfuqitë ishin armiku i përbashkët i njerëzimit dhe se 'Bota e Tretë', ishte forca kryesore kundër imperializmit, kolonializmit dhe hegjemonizmit.<sup>106</sup> Po në atë shkrim, sipas teorisë së Maos, jepeshin arsyet përse 'Bota e Dytë' ishte një forcë e cila mund të bashkohej me të tretën në një front të bashkuar ndërkombëtar kundër hegjemonisë së superfuqive.<sup>107</sup>

Kongresi XI i Partisë Komuniste Kineze që u mbajt në gusht të vitit 1977, solli ndryshimin që pritej pas vdekjes së Maos në politikën e jashtme të vendit.<sup>108</sup> Vendimet e këtij Kongresi hodhën poshtë afrimin e shpejtë të mundshëm të Kinës me Bashkimin Sovjetik, dhe e rreshtuan vendin në një front të bashkuar me SHBA-në kundër hegjemonisë sovjetike.<sup>109</sup> Ja përse, pas kongresit, udhëheqësit e rinj kinezë nën drejtimin e Ten Hsiao Pinit deklaruan se dëshironin të shihnin më shumë progres në marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë administratës së presidentit Karter.<sup>110</sup>

Hapjes së Kinës me botën, aleatja e saj e vogël ballkanike iu përgjigj me vetëizolim. Është shumë domethënëse fjala e Ten Hsiao Pinit "megjithatë kockën do ta brejnë mizat",<sup>111</sup> thënë pas deklaratës së Mehmet Shehut i cili shprehej se "Shqipëria është një kockë e mprehtë si

<sup>105</sup> J. Yu-shek Cheng, *China's Foreign Policy...*, f. 45.

<sup>106</sup> *Po aty*.

<sup>107</sup> *Po aty*, f. 45-46.

<sup>108</sup> *Po aty*.

<sup>109</sup> *Po aty*, f. 46.

<sup>110</sup> *Po aty*.

<sup>111</sup> *AMPJ*, V. 1977, D. 231, fl. 111. Dëshifrim tepër sekret dërguar Enver Hoxhës, Mehmet Shehut dhe Ministrisë së Jashtme nga Pekini, 27 tetor 1977.

thikë"<sup>112</sup>. Vetë Enver Hoxha do të deklaronte edhe më ashpër në Kuvendin Popullor s'e "ne nuk u lidhëm me Kinën për pesë plaçka"<sup>113</sup>, duke bërë sikur harronte që Kina për 20 vjet e kusur kishte ndihmuar e financuar në ndërtimin e qindra veprave të rëndësishme anembanë vendit. Politika e "dyerve të hapura" ndaj vendeve imperialiste e kapitaliste të çdo kategorie,<sup>114</sup> siç paraqitet nga një studim i ambasadorit shqiptar në Pekin, Behar Shtylla, nuk ishte e pranueshme për politikën dogmatike të Enver Hoxhës. Njësoj siç kishte vepruar ndaj jugosllavëve më 1948, ndaj sovjetikëve më 1961, dhe tani ndaj kinezëve më 1978, Enver Hoxha shkëputej nga çdo aleancë me vende komuniste nëse këto të fundit nuk vijonin të ruanin traditën më të egër të stalinizmit. Ruajtja me çdo kusht e pushtetit të tij personal ishte qëllimi primar. Çdo gjë tjetër, nuk kishte rëndësi. Njësoj siç kishte vepruar ndaj jugosllavëve më 1948, ndaj sovjetikëve më 1961, dhe tani ndaj kinezëve më 1978, Enver Hoxha shkëputej nga çdo aleancë me vende komuniste nëse këto të fundit nuk vijonin të ruanin traditën më të egër të stalinizmit. Ruajtja me çdo kusht e pushtetit të tij personal ishte qëllimi primar. Çdo gjë tjetër, nuk kishte rëndësi.

### Përfundime

"Teoria e Tri Botëve" ishte në fakt pararoja e teorisë së re kineze të shekullit XXI të "Harmonisë Botërore" e cila përfshinte marrëdhëniet shumëpalëshe dhe sigurinë e përbashkët; bashkëpunim bazuar mbi përfitime të ndërsjella për të realizuar prosperitet të përbashkët dhe, ndërtimin e një bote në harmoni bazuar mbi tolerancën dhe pranimin e ndërsjellë.<sup>115</sup> Që nga viti 1974, udhëheqësit kinezë po artikulonin me

<sup>112</sup> *Po aty*.

<sup>113</sup> ABC story, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze*, pjesa e dytë, 26 janar 2017.

Site: <https://www.youtube.com/watch?v=-Zxf2xfmxiY>

<sup>114</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1977, D. 3, fl. 31. Studim i ambasadorit të RPS të Shqipërisë në RP të Kinës, Behar Shtylla, mbi luftën midis rrymave dhe grupeve të ndryshme në udhëheqjen e PK të Kinës gjatë periudhës 1976-1977 (si janë zhvilluar ngjarjet në Kinë këto 18 muaj; vdekja e Çu En Lait, fushata kundër Ten Siao Pinit e deviacionit të djathtë, vdekja e Mao Ce Dunit dhe lufta midis dy grupeve, grupi i Hua Kuo Fenit mundohet të konsolidojë pushtetin; rrënjët ideologjike dhe historike të ngjarjeve të fundit në Kinë; në ç'drejtim po zhvillohen ngjarjet në Kinë).

<sup>115</sup> J. Yu-shek Cheng, *China's Foreign Policy...*, f. 14.

kujdes vendosjen e një rendi të ri botëror. Ky artikulum ndërthurte pjesë të ideologjisë marksiste-leniniste me idetë e së majtës së re evropiane.<sup>116</sup>

Ekonomia e Kinës pas vitit 1978, u strukturua në një mënyrë të veçantë duke i hapur rrugë "tregëzimit-marketization", ndryshe nga fqinji i saj komunist verior, Bashkimi Sovjetik.<sup>117</sup> Në Shqipëri, ekonomia u centralizua edhe më tepër dhe populli filloi të vuajë pasojat e vetizolimit. Në Kinë, në kontrast nga Shqipëria, ekonomitë provinciale u kthyen në të pavarura dhe zhvilluan planifikimin e tyre të pakontrolluar nga aparati qendror.<sup>118</sup> Kjo u bë edhe për një shkak tjetër që ka lidhje me teorinë e Maos. Duke patur frikë nga ndonjë sulm i huaj, Mao në vitet e fundit të jetës së tij, inkurajoi pavarësinë ekonomike të provincave duke zhvilluar planifikimin e pavarur të tyre nga qendra.<sup>119</sup>

Ndryshimet në politikën e jashtme të vendeve që e ndihmonin të ruante pushtetin, Enver Hoxha për t'u justifikuar përpara popullit (për aq sa mund të vlente), i paraqiste si tradhti ndaj marksizëm-leninizmit. Enver Hoxha nuk kuptonte se s'ekzistonte një ekuilibër ndërmjet përpjekjes për të promovuar komunizmin dhe nevojave të popullit shqiptar për mirëqenie. Injoranca dhe prapambetja e popullit shqiptar shoqëruar edhe me varfërinë e plotë ishin aseti kryesor në pushtetin e Enver Hoxhës. Enver Hoxha nuk njihte as parimin tjetër të botës Euro-Atlantike, vetëpërmbytjen. Marrëdhëniet normale mes dy shteteve vijnë si rezultat i vetëpërmbytjes dhe zotësisë për të njohur kufijtë personalë. Aventura politike e Enver Hoxhës shkonte deri në kufijtë e mbijetesës. Mënyra sesi Enver Hoxha drejtoi Shqipërinë për 40 vjet nuk e lejonte të bënte eksperimente doktrinash që të mund të cenonin pushtetin e tij të pasfidueshëm brenda vendit. Asetin e aleancave afatgjata udhëheqësi komunist shqiptar nuk e merrte në konsideratë. Injorimi i këtij aseti do të çonte politikën e Enver Hoxhës dhe vendin në vetizolim të plotë.

<sup>116</sup> Suisheng Zhao, "China's Pragmatic Nationalism; Is It Manageable?", në *Washington Quarterly*, vol. 29, no. 1, Washington: 2005/2006, f. 131.

<sup>117</sup> Hongbin Cai and Daniel Treisman, "Did government decentralization cause China's economic miracle?", në *Politics of Modern China*, vol. II, ed. by, Yongnian Zheng, Yiyi Lu and Lynn T. White III, London & New York: Routledge, 2010, f. 88.

<sup>118</sup> Po aty.

<sup>119</sup> Po aty, shih edhe Alfred J. Chandler, *Strategy and Structure*, New York: Doubleday, 1962; Olivier Williamson, *Markets and Hierarchies*, New York: Free Press, 1975; Qian and Xu (n.11).

*S u m m a r y*THE ALBANIAN-CHINESE CLOSE RELATIONS DURING THE COLD WAR  
AND THE THREE WORLDS THEORY

The "Theory of the Three Worlds" was managed to play a very significant role in China's foreign and domestic policies. Chinese nationalism has been exploited to fill the ideological vacuum in the era of the economic reforms during the late seventies, but without losing the trust in the Party and the government and in the superiority of socialism. Under the pragmatic leadership of Deng Xiaoping, Mao's theory of "Three Worlds" was focused and depended more and more on the West for capital and advanced technology to fasten and control the economic growth. On November 1<sup>st</sup> 1977 replying to the Albanian critique to the theory of "Three Worlds", the People's Daily newspaper published a long article which echoed the Chairman's Mao theory to better understand the differentiations of the three worlds and explaining why Mao's theory was a great contribution to Marxism-Leninism.

In contrast with Mao's theory, the Albanian leader, Enver Hoxha, was very much focused on how to preserve the proper political power and was always against any substantial change in the communist world. After the break of the relations with the Soviet Union, the alliance with Red China was like a safe boat for his power. He aligned with China as long as the great Asian country was pursuing the harsh stalinist policy. When China opened oneself to the world, and especially after the secret visit of Henry Kissinger in July 1971, Enver Hoxha was aware that even this alliance has come to an end. The theory of "Three Worlds" did not suit to Enver Hoxha and his power, and for this reason he attacked it till the relations with People's Republic of China were frozen.

